



## PROCESVERBAL

### Nga mbledhja e IV-të për vitin 2011, e Kuvendit Komunal në Vushtrri, mbajtur më 28.4.2011

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri, përveç Ergin Sungurit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë.

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit-** propozoi që në “të ndryshme” të futet Propozim-vendimi për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të lokaleve të dy shkollave të mesme të ulta në qytet. Gjithashtu propozoi që pikës nr. 11 nën-pika “c” të rendit të ditës t’i shtohen edhe tri propozim-vendime.

**Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të LDK-së kërkoi që katër propozim-vendimet e sjellura në material shtesë për këtë seancë të shtyhen për seancën e radhës, pasi që kjo seancë është shumë e ngarkuar. Poashtu kërkoi që të shtrohet përgjegjësia e dështimit të mbledhjes së parafundit të seancës së Kuvendit, dhe në fund kërkoi sqarim nga Kryetari i Komunës për përfshirjen e drejtorit të arsimit në dy incidente.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të AAK-së paraqiti këto pyetje: pyeti lidhur me pronat në Stanoc të Poshtëm, Lummadh dhe Nedakoc, duke kërkuar të informohen se si qëndron puna me ato prona, dhe kërkoi që të pajisen me nga një kopje të atyre kontratave (vendimeve), pra të bëhet një transparencë lidhur me ato prona, pasi që po dyshohet se nuk po shkojnë mirë punët me ato prona, që janë pronë e komunës. Kurse në pikën 11 të rendit të ditës kërkoi që të shtohet që në kuadër të ndihmave dhe subvencioneve edhe ndihma për Shoqatën e Martirëve të Lirisë në Vushtrri. Mandej kërkoi që të informohet nga kryesuesi pse mungon raporti i të hyrave vetanake për tremujorin e parë, pasi që në secilin tremujor duhet të kemi raportin e të hyrave vetanake.

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit-** në vazhdim të punimeve të seancës së kuvendit, njoftoi se është zgjedhur shef i Grupit parlamentar të PDK-së Shpëtim Zhegrova.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të PDK-së kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës pika nr. 5, pasi që është e jashtëligjshme, bazuar në nenin 40.2, paragrafi “h” i LVL-së. Gjithashtu, kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës nënpika “h” e pikës 11 të rendit të ditës, pasi që Bajram Pantina tashmë është i vdekur, prandaj në këto rrethana të reja nuk është e arsyeshme t’i ndahen 1.500 €.

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit-** tha se në mbledhjen e kaluar të kuvendit, e kemi bërë një kërkesë dhe kemi thënë që kuvendi ose kryesuesi i kuvendit, ose kryetari i komunës ta bëjnë një reagim në emër të qytetarëve të Vushtrrisë për bisedimet politike që janë duke u zhvilluar në mes të Kosovës dhe Serbisë, sepse ne nuk jemi të kënaqur me delegacionin i cili është duke zhvilluar bisedime, dhe shtoi se kryesuesi i kuvendit nuk e ka bërë një reagim të tillë në emër të qytetarëve të Vushtrrisë, dhe se nuk ka marrë përgjigje se si është proceduar me këtë kërkesë, prandaj kërkoi që propozimet që i bëjnë anëtarët e kuvendit, të mos mbeten vetëm propozime deklarative, por të zyrtarizohen, duke u proceduar siç duhet, dhe Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë duhet të jetë në korelacion të vazhdueshëm me Kuvendin e Kosovës. Në fund kërkoi që propozimi i tij të diskutohet dhe të merr një përgjigje.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** paraqiti vërejtje lidhur me shënimin “shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së”, duke shtuar se mbledhja paraprake e KK-së është mbajtur me 21.04.2011, kurse procesvebalin e mbledhjes paraprake nuk e kemi.

**Bahrije Pllana, anëtare e Kuvendit-** propozoi që në “të ndryshme” të debatohet lidhur me mungesën e energjisë elektrike në komunën tonë.

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit-** duke iu referuar çështjes së ngritur nga anëtari i Kuvendit S. Kadriu, tha se Parlamenti i Kosovës ka vendosur për bisedimet Prishtinë-Beograd, prandaj kuvendi i komunës nuk është i mandatuar për të diskutuar apo për të marrë vendim për çështjen në fjalë.

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit-** lidhur me propozimin e shefit të Grupit parlamentar të PDK-së që të hiqet nga rendi i ditës pika nr. 5, tha se nuk pajtohet pasi që nuk është në kundërshtim me LVL-në, por është kompetencë ekskluzive dhe e rezervuar për kuvendin, mirëpo mund të diskutohet për nenin 5 të kësaj rregulloreje, i cili ka nevojë të korrigjohet.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** lidhur me propozimin e anëtarit të kuvendit Q. Azemi, tha se nuk është kundër, por është dashtë ta sjellin një kërkesë me shkrim, e cila shërben si mbështetje në të. Pastaj lidhur me çështjen e mungesës së raportit tremujor financiar, tha se arsyeja qëndron në faktin se seanca e muajit mars nuk është mbajtur, prandaj arsye tjera për mungesën e raportit në fjalë nuk ka. Për pikën nr. 5 të rendit të ditës, tha se nuk është i mendimit që të hiqet nga rendi i ditës, pasi që është shqyrtimi i parë, por mund të jepen vërejtjet konkrete dhe në shqyrtimin e dytë të vjen e korrigjuar. Ndërsa për nënpikën “h” të pikës nr. 11 të rendit të ditës, tha se është mirë që të mbetet në rend dite dhe t’i ndihmohet me një ndihmë të vogël për t’i mbuluar shpenzimet e varrimit.

**Esat Beka, anëtar i Kuvendit-** tha se e mbështetë kërkesën e shefit të Grupit parlamentar të PDK-së që të hiqet nga rendi i ditës propozim-vendimi për ndihmë të ndjerit Bajram Pantina, sepse i njëjti ka kërkuar ndihmë për shërim, kurse kërkuesi në fjalë ka ndërruar jetë, por sipas ligjit kryetari i komunës ka të drejtë deri në 500 € t’iu ndan rasteve që vlerësohen të nevojshme për t’iu ndihmuar.

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit-** në fund të diskutimeve për rend dite, propozoi që të hyn në rend dite propozimi për ndihmë Shoqatës së Martirëve. Poashtu propozoi që të hiqet nga rendi i ditës pika nr. 5 e rendit të ditës. Gjithashtu, propozoi që pikës nr. 11 nënpika “c” të rendit të ditës t’i shtohen edhe tri propozim-vendime. Kurse në “të ndryshme” të futet Propozim-vendimi për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të lokaleve të dy shkollave të

mesme të ulta në qytet, dhe të debatohet çështja e mungesës së energjisë elektrike në Komunën e Vushtrrisë.

**Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 19 vota “për”, 4 “kundër”, të tjerët “abstenim” aprovoi këtë:**

## **R E N D I T E**

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e KK-së.**
2. **Raporti i punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2010.**
3. **Shqyrtimi dhe aprovimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të Statutit të Komunës.**
4. **Draft-Rregullore për shërbimin e transportit me “merimangë” për territorin e Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i parë).**
5. **Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim pa kompensim të tokës në pronësi të Komunës për ndërtimin e objektit për regjistrimin e automjeteve dhe Qendrën e Regjistrimit Civil nga MPB-ja.**
6. **Propozim-vendimi për racionalizimin e ujit të pijes nga rrjeti i ujësjellësit të qytetit gjatë sezonës verore.**
7. **Propozim-vendimi për lejimin e bartjes së mjeteve financiare nga të hyrat vetanake prej vitit 2010 në vitin 2011.**
8. **Propozim-vendimi për përcaktimin e lartësisë së kompensimit të anëtarëve të Komitetit për Auditim të Komunës së Vushtrrisë.**
9. **Propozim-vendimi për anulimin e vendimit të KK-së për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës së paluajtshme të komunës.**
10. **Propozim-vendimet për lejimin e mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për:**
  - a. **Blerjen e kohë pas kohshme të gjërave ushqimore për familjet në gjendje të rëndë ekonomiko-sociale.**
  - b. **Bartjen e mjeteve financiare për rindërtim për familjet me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale.**
  - c. **Propozim-vendimi për ndihmë për klubet sportive të Komunës së Vushtrrisë.**
  - c1. **Propozim-vendimi për ndihmë ekipit të futbollit “Radnik” nga Prelluzha.**
  - c2. **Propozim-vendimi për ndihmë KV-Gjimnazisti dhe KKBOX “Kosova” (F+M).**
  - c3. **Propozim-vendimi për ndihmë Klubit të shahut “Llamkos”.**
  - d. **SHFD-në e UÇK-së, në shumë prej 3600 €.**
  - e. **OVL-në e UÇK-së, në shumë prej 3600 €.**
  - f. **SHIL-in e UÇK-së, në shumë prej 3600 €.**
  - g. **Shoqatën e Ish të Burgosurve Politik, në shumë prej 1800 €.**
  - h. **Ndihmë për Shoqatën e Martirëve në Vushtrri, në shumë prej 1800 €.**
  - i. **Ndihmë në vlerë prej 1500 €, për familjen e Bajram Pantinës, ish punëtor i Komunës.**
  - j. **Ndihmë për shërim për Arben Mujën, nga Vushtrria.**
11. **Të ndryshme:**
  - a. **Propozim-vendimi për themelimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të lokaleve të dy shkollave të mesme të ulta në qytet: SHMU 1 dhe SHMU 2.**
  - b. **Diskutimi lidhur me çështjen e mungesës së energjisë elektrike në Vushtrri.**
  - c. **Pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.**

## **1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e KK-së.**

**Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit-** lidhur me pikën nr. 10, nën "a", tha se nuk duhet të figuron fare përfundimi "Lokalet në fjalë ipen në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, me mundësi vazhdimi", pasi që jemi dakorduar që të formohet një komision për çështjen në fjalë dhe të jepet me kompensim përmes tenderit.

**Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit-** në pikën nr. 4 në diskutimin e tij, kërkoi që te fjalua "vlerësoi pozitivisht rezultatet e paraqitura nga investimet kapitale", të korrigojohet në këtë mënyrë "vlerësoi pozitivisht strukturën e investimeve kapitale".

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Aprovohet procesverbali i mbledhjes së fundit të Kuvendit të Komunës, me vërejtjen e paraqitur nga: M. Shabani dhe R.Ramaj.***

## **2. Raporti i punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2010.**

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** tha se prioritet i tij dhe i qeverisë komunale ka qenë realizimi i të gjitha projekteve të planifikuara në vitin 2009, për t'u realizuar në vitin 2010. Pastaj në prioritet ka qenë realizimi i të hyrave vetanake, duke shtuar se ka përmirësim të theksuar nga të hyrat e tatimit në pronë. Në vazhdim bëri një rekapitullim të të gjitha projekteve të vitit 2010, duke njoftuar se gjatë këtij viti janë realizuar 31 projekte për asfaltim në gjatësi mbi 26 kilometra; 23 projekte për shtrim të rrugëve me kubëza në gjatësi mbi 7 kilometra; 12 projekte për kanalizim në gjatësi mbi 6.000 metra; 30 projekte për furnizim me gypa të kanalizimit në gjatësi mbi 4.000 metra; 11 projekte për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në gjatësi mbi 72.000 metra; janë ndërtuar 5 ura të vogla, dhe janë realizuar edhe 69 projekte tjera. Pra, në total janë realizuar 181 projekte, kurse për këto projekte janë investuar mbi 22 milionë euro. Pastaj, njoftoi që me mjetet e planifikuara nga granti qeveritar dhe nga të hyrat vetanake, ka pasë mjete që kanë tepruar prej disa projekteve dhe falë këtyre mjeteve i kemi realizuar edhe disa projekte tjera në Sumë, Samadrexhë, Dolak, Zhilivodë, Bivolak dhe Hamidi, mirëpo vlen me theksuar se kanë mbetur edhe tri projekte, dy prej të cilave janë në realizim e sipër në këtë vit përmes një marrëveshjeje mirëkuptimi në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Komunës për asfaltimin e rrugëve në Beçuk, Ashlan dhe Akrashticë. Gjithashtu ka mbetur pa u realizuar edhe projekti për shtrirjen e ujësjellësit në fshatrat e Çiçavicës, por shtoi se për realizimin e këtij projekti ka mbështetje nga Qeveria e Austrisë. Në vazhdim paraqiti në mënyrë të detajuar investimet nga Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2010, duke përmendur asfaltimin e rrugëve në këto fshatra: Dobërllukë, Banjskë, Mihaliq, Ashlan, Akrashticë (një pjesë e rrugës). Gjithashtu, njoftoi për një marrëveshjeje me Ministrinë e Pushtetit Lokal, me ç'rast janë realizuar disa projekte për shtruarjen në kubëza, për kanalizimin në fshatin Maxhunaj, kurse punimet për ndërtimin e fabrikës së ujit (donacion nga Qeveria e Kosovës) pritet të fillojnë brenda dy javëve. Mandej donacione të Qeverisë së Kosovës janë edhe asfaltimi i rrugës Vërmicë-Kollë, Beqiq-Duboc, Galicë-Vojtesh, kurse Ministria e Kulturës ka bërë disa investime në hulumtime arkeologjike në Kalanë e qytetit tonë. Pastaj vlen të përmenden edhe investimet e mëdha nga donatorët e jashtëm, e në veçanti ndihma nga Qeveria e Tirolit, e cila vetëm vitin e kaluar Komunës së Vushtrrisë ia ka dhuruar tri automjete të zjarrfikësve, kurse janë duke u punuar edhe katër garazha për automjete të zjarrfikësve. Gjithashtu, edhe USAID-i ka ndihmuar komunën tonë për realizimin e disa projekteve, e që disa prej tyre janë: meremetimi i shkollës së mesme "Bahri Haxha", por për një pjesë të këtij projekti ka participuar edhe komuna, pastaj projekti për ngritjen e kapaciteteve për transparencë në Kuvend për promovim të zhvillimit të ekonomisë lokale, për performancë komunale etj. Mandej Qeveria Daneze ka investuar në laboratorin e

teknologjisë ushqimore në shkollën “Bahri Haxha”, duke e furnizuar edhe me 35 kompjuterë shkollën në fjalë. Gjithashtu, vlen të përmendet që edhe KFOR-i francez dhe ai sloven përveç përkujdesjes për sigurinë, kanë bërë edhe disa investime në komunën tonë. Pastaj OSBE-ja ka investuar në inventarizimin e arhivës komunale. Në vazhdim tha se ka bërë përpjekje maksimale që të zbatohet ligji lidhur me kryerjen e obligimeve ndaj komunës, si në tatim në pronë, taksë në firmë, pagesën e lejeve ndërtimore. Në fund tha se ndër problemet me të cilin është duke u ballafaquar komuna janë uzurpimet publike.

**Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit-** lidhur me raportin në fjalë, shprehu mirënjohjen e tij për çdo investim që është bërë në komunën tonë për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Por, në këtë raport, sa i përket pasqyrave financiare, mjetet e bartura prej vitit 2009 në 2010 nuk përputhen prej pasqyrës financiare të komunës në këtë pasqyrë që janë paraqitur këtu, pasi që në pasqyrat financiare të komunës që janë paraqitur në njërin nga mbledhjet e kaluara shuma e mjeteve të bartura 2009-2010 është 309.000 €, kurse këtu figuron shuma 516.000 €. Sa i përket granteve dhe ndihmave, tha se ka mospërputhje alarmante të shifrave. Sa i përket realizimit të të hyrave vetanake, gjithmonë janë cekur vetëm dy pozicione, pra Komuna e Vushtrrisë në inkasimin e të hyrave është e varur vetëm nga dy pozicione: nga të hyrat vetanake të tatimit në pronë dhe nga taksa komunale, dhe askund nuk është përmendur dështimi në pozicionet tjera të zërave që mund të mblidhen më shumë të hyra vetanake. Ndërsa, lidhur me projektet e realizuara gjatë vitit 2010, nëse ky tabelar i vitit 2010 krahasohet me tabelarin e vitit 2009, shihet se shumë projekte të vitit 2009 janë përshkruar në vitin 2010, prandaj nuk mund të thuhet se për dy vite janë realizuar projekte afro 45 milionë euro, pasi që nuk mund të konsiderohet një projekt i realizuar, kurse objekti i komunës akoma nuk ka filluar, poashtu nuk mund t'i thuhet një projekt që është realizuar, kur fabrika e ujit nuk ka filluar akoma. Ndërsa, lidhur me raportet e drejtorive, sipas Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim në Komunën e Vushtrrisë janë të regjistruara 2820 biznese, ndërsa sipas raportit të të hyrave vetanake qershor 2010 thuhet se gjithsejt biznese aktive në Komunën e Vushtrrisë janë 1261, pasive 431, e në total del se janë 1692 biznese. Sipas raportit të drejtorisë në fjalë thuhet se vazhdim të lejeve janë 411, leje pune të reja janë 139, leje të përkohshme janë 29, dhe vazhdim të lejeve të përkohshme janë 103, që në total bëjnë 682 leje, pra nga këto 2820 biznese janë pajsiur me 682 leje pune, ndërsa pajisja me leje pune duhet të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Mandej mungon informata mbi numrin e bizneseve aktive që afarojnë në komunën tonë dhe numrin e bizneseve ilegale që punojnë dhe që janë një numër i konsiderueshëm. Gjithashtu, mungon informata mbi numrin e të punësuarëve në sektorin privat në Komunën e Vushtrrisë. Pastaj është alarmante që drejtorja në fjalë nuk ka mbajtur asnjë takim me komunitetin e bizneseve, prandaj kërkoi nga qeveria komunale që të inicohet formimi i shoqatës së afaristëve në Komunën e Vushtrrisë, dhe përmes kësaj shoqate të gjitha brengat dhe kërkesat e komunitetit të biznesit të debatohen në Kuvend. Ndërsa, lidhur me raportin e të hyrave vetanake të Drejtorisë së Buxhetit, tha se ekziston një mori mospërputhjes, që nuk guxon të ndodhin në çështje financiare.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** tha se raporti në fjalë përmban shprehje dëshirash të vullnetit të mirë për të arritur rezultate të caktuara në lëmi të caktuara, por nuk ka parametra të matshëm, dhe fakti që nuk ka parametra të matshëm nënkupton se në raportin në fjalë mungon planifikimi, pra në bazë të këtij raporti nënkuptohet se shumë pak rëndësi i kushtohet planifikimit, kurse në realitet planifikimi meriton një vëmendje të posaçme dhe rreth 80 % e angazhimit duhet të shkonte në planifikim, kurse rreth 20 % në zbatim të asaj që është planifikuar. Pastaj tha se kryetari në raportin e tij do të duhej t'i referohej pikë për pikë planit të vet të punës për vitin 2010 dhe të tregonte se në ç'masë është arritur të përmbushej plani i tij. Mandej disa objektiva që i ka paraqitur kryetari në planin e tij të punës, por edhe që kanë qenë premtime të tij gjatë fushatës parazgjedhore, nuk i ka realizuar, disa prej tyre janë: themelimi i Entit të patates; ndërtimi i parkut të biznesit. Gjithashtu, rikujtoi se jo vetëm në planin e vitit 2010, por

edhe në planin e punës së vitit 2009, kryetari ka premtuar se gjatë vitit 2009 do të zyrtarizohen emërtimet për të gjitha shkollat e pavarësuara, kurse sot po bëhen gati tri vite dhe 5 apo 6 shkolla në Komunën e Vushtrrisë funksionojnë pa emra. Gjithashtu, në planin e punës të kryetarit për vitin 2010 përmendet themelimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe rritja e kapaciteteve planifikuese të stafit të saj, por as kjo nuk është përmbyllur. Mandej, në raportin e kryetarit kur bëhet fjalë për bujqësinë, është përmendur ngritja e plantacioneve, serrave, kurse qysh atëherë kemi kërkuar që kryetari të bën planifikim dhe të tregoj se sa sipërfaqe të tokës parashihen të krijohen plantacione ose serra, dhe tash në këtë raport ishte parë se a e ka përmbyllur atë pjesë të planit apo jo, në ç'masë e ka përmbyllur, nëse nuk e ka përmbyllur cilat janë arsyet që nuk ka arritur ta përmbyllur. Mandej kur bëhet fjalë për të hyrat apo shpenzimet, kryetari në planin e tij do të duhej të tregoj se gjatë vitit 2010 ka paraparë uljen e shpenzimeve për 5 %, dhe në bazë të këtij raporti do ta kuptonim në ç'masë është realizuar. Lidhur me administratën e komunës, kryetari ka përmendur se gjatë këtij viti i ka pranuar 534 kërkesa, prej të cilave 81 janë miratuar, mbi 100 janë refuzuar, kurse mbi 300 kërkesa janë në proces, që nënkupton se ka përfunduar viti 2010, dhe më tepër se gjysma e kërkesave janë akoma në proces, dhe kjo tregon një neglizhencë. Në fund lidhur me çështjen e prokurimit, është konstatuar në raport se ka ekzistuar një diferencë mbi 688.000 €, dhe pyeti pse ka ardhur deri te kjo diferencë, duke shtuar se kjo flet për mungesë planifikimi.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit**- tha se raporti në fjalë i ka disa mangësi, duke shtuar se janë disa indikatorë që tregojnë se puna e kryetarit dhe e qeverisë komunale nuk ka qenë e suksesshme gjatë vitit 2010, pasi që është thelluar varfëria, pastaj shkurtime të buxhetore, problemi i krahmotshëm i ujit, dhe shtoi se jemi komunë afër ujit, por ujë nuk ka, dhe premtimet që janë dhënë nuk po realizohen, punët po shkojnë shumë ngadalë, kurse çështja e ujit është problem jetik i qytetarëve. Poashtu është problemi i papunësisë, mungesa e transparencës dhe shumë probleme tjera, që tregojnë se nuk kanë shkuar punët mirë. Në vazhdim si shembull që është menaxhuar keq prona komunale, përmendi dështimin e fabrikës në Nedakoc, mandej problemi në Stanoc të Poshtëm, në Lumëmadh, pra ka uzurpime të shumta në të dy krahët e magjistrale Vushtrri-Prishtinë, duke shtuar se atje ndërtohet me leje dhe pa leje mbi tokën e bukës, mbi tokën që është nën komosacion. Pastaj, nuk ka asnjë shembull që komuna e ka kthyer tokën e vet. Lidhur me menaxhimin e parasë publike, tha se nuk ka qenë mbikëqyrja e mjaftueshme, pasi që ka munguar raporti i Auditorit të Brendshëm, pra nuk ka pasur inspektim, kurse në vitin 2009 kemi pasur të gjetura të rrezikut të lartë. Poashtu, ka pasur mungesa tek zbatimi i ligjit, te disiplina, duke shtuar se ka shkolla pa emra, pastaj pyeti se si është zbatuar ligji kur ka shkollë që i ka dy emra, e ajo është shkolla në fshatin Dobërllukë, dhe kjo tregon se po luhet me institucione (me emra të shkollave). Në vazhdim theksoi se problem është edhe emërimi i drejtorëve, mandej mungesë tjetër tek puna e kryetarit është tubimi me qytetarë, pasi që këtu ka qenë i pasuksesshëm. Pastaj në raportin në fjalë, te Drejtoria e Arsimit, tha se planifikimi nuk ka përfunduar ashtu siç është bërë, pasi që disa shkolla janë hequr, poashtu nuk figuron furnizimi me material pedagogjik, mandej nuk është përmendur që numri i madh i nxënësve në paralele po e degradon suksesin, prandaj në të ardhmen edhe dy shkollat tjera profesionale duhet me pasë një paramasë, kurse sukcesi i nxënësve është i fryer, prandaj kërkoi që të paraqitet një gjendje me reale, duke kërkuar që ai raport ashtu siç është tani, të përmirësohet.

**Xhylsime Feka, anëtare e Kuvendit**- raporti në fjalë është një raport i hartuar brenda konditave ligjore dhe Statutit të Komunës, i ka të gjitha atributet e deri edhe akseset e një raporti, që edhe e bën përmbyllësor, të kompletuar dhe ligjërish të pranuar. Ky raport është përmbyllur dhe shkruar e një pune të përkushtuar e kryetarit, duke filluar nga inkasimi i të hyrave vetanake, ku të dhënat japin një pasqyrë në rritje të konsiderueshme dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre e realizuar në investime kapitale, kurse një pjesë e mirë është realizuar edhe nga donacionet, apo edhe nga fondi 31, gjë që e vë në pah angazhimin mjaft serioz dhe azhurant të kryetarit. Në

vazhdim e vlerësoi pozitivisht edhe punën në realizimin e të ardhurave nga tatimi në pronë, e që të dhënat japin një pasqyrë në rritje në këtë drejtim. Mandej tha se janë realizuar dhe janë duke u realizuar shumë projekte që janë me rëndësi të veçantë për mirëqenien e qytetarëve, mandej është bërë punë në ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarët, falë punës së përkushtuar dhe trajtimit serioz të kryetarit, duke respektuar dhe zbatuar ligjin. Në fund tha se përkundër punës së madhe, mbeten ende punë dhe sfida që kemi besim në tejkalimin e tyre, siç janë: problemet në arsim, ruajtja e sigurisë nëpër shkolla, rritja e suksesit në mësim, shtimi i efikasitetit në punë për të gjithë stafin nëpër shkolla, pastërtia në qytet dhe disa probleme tjera të vogla, që besojmë se në të ardhmen me punën dhe angazhimin e kryetarit do të tejkalohen pa ndonjë problem, kurse çështja e barazisë gjinore mbetet ende një sfidë që duhet tejkaluar.

**Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit-** pasi që përshëndeti raportin e punës së kryetarit për punën që ka bërë në interesin qytetar, paraqiti vërejtjet e tij rreth Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, duke shtuar se pasi që Komuna e Vushtrrisë ka edhe nivelin primar dhe sekondar, duhet të ipen përqindjet e vitit 2009-2010 të pacientëve dhe të shihet një pasqyrë më reale se sa është rrit numri dhe sa janë shtuar vizitat, gjithashtu edhe lidhur me shërbimin e vaksinimit vlen i njëjti problem, pasi që duhet ta shohim qysh ka qenë në vitin 2009 dhe qysh është në vitin 2010. Prandaj lidhur me vaksinimin paraqiti dilemat e tij se sa është real, sa është realizuar, dhe si duhet të jetë, pasi që kemi pasë vërejtje se përqindja ka qenë më e vogël, ndërsa këtu ka dal shumë e madhe. Mandej, tha se mungon raporti rreth cilësisë së ujit të pijshëm në nivelin komunal, që duhet të shkon në analizat mikrobiologjike në Institutin e Shëndetit Publik se çfarë cilësie të ujit përdor qytetari i Vushtrrisë dhe kush e bën dhe kush raporton. Komuna ka për obligim për qytetarët e vet të din se çfarë cilësie të ujit ka në tërë territorin e Vushtrrisë, pasi që uji është pjesë e jetës. Gjithashtu mungojnë të dhënat rreth sëmundjeve ngjithëse për Komunën e Vushtrrisë, hepatitet, tumoret, diabetet dhe sëmundjet të cilat e ngarkojnë shumë edhe buxhetin, punën dhe trajtimin, prandaj do të duhej ta kemi një pasqyrë para anëtarëve të kuvendit komunal. Pastaj duke iu referuar skemës për ndihma sociale, tha se pasi që një pjesë e kompetencave nga ministria është bartë në nivelin lokal duhet ta kemi një skemë nga e cila kuptohet se kush merr ndihma sociale dhe kush i shfrytëzon ato. Në fund kërkoi që secili delegat ta ketë një raport rreth ndërtimit, strehimit, pra kujt iu kanë ndarë, me emër dhe mbiemër, në mënyrë që të pasqyrohet gjendja faktike, dhe të kuptohet se si janë shfrytëzuar mjetet dhe si është shfrytëzuar paraaja publike.

**Xhemajl Pllana, anëtar i Kuvendit-** tha se raporti në fjalë është kryesisht përshkrim i raporteve të drejtorive përkatëse të komunës, dhe vëri në spikamë disa dukuri jologjore, disa keqpërdorime të parasë publike dhe një keqmenaxhim të përgjithshëm, duke shtuar se janë disa shkolla të pavarësuar që nga viti 2008, ndërsa në listë të pagave vulosen me emër tjetër, disa shkolla janë pavarësuar nga MASHT-i, ndërsa në listën e pagave qëndrojnë në një listë, dhe përmendi si shembull shkollën fillore “Ali Kelmendi”, e cila ka në listë edhe punëtorët e tri shkollave tjera, pra në një listë janë tre drejtorë dhe dy zv.drejtorë. Mandej ka raste kur zgjidhet drejtori me konkurs për një shkollë tjetër, ndërsa punon në një shkollë tjetër. Gjithashtu, shkolla e Dobërllukës është pavarësuar nga MASHT-i dhe është emërtuar me emrin “Latif Berisha”, ndërsa në listë të pagave nuk është bërë ndarja dhe vazhdon të jetë e bashkuar me shkollën e Smrekonicës. Pastaj shkolla e mesme është emëruar me emrin “Bahri Haxha”, kurse në listë të pagave figuron akoma me emrin “Latif Berisha”. Në vazhdim tha se në Komunën e Vushtrrisë janë 33 institucione arsimore, ndërsa në listë të pagave figurojnë 24 institucione arsimore, sepse në një listë të pagave ka nga dy dhe tri shkolla. Pastaj ushtruesit e detyrës së drejtorit paguhen me pagë të drejtorit, që përbën shkelje të rëndë ligjore, dhe ata janë me shkollë të mesme normale ose me shkollë të lartë pedagogjike, dhe përmendi rastet në Zhilivodë, Akrashticë, Stanoc të Poshtëm dhe Ashlan. Poashtu, pyeti se nga dalin 20 paralele të ndara, përderisa konsiderohen si

shkolla amë? Në listë të pagave ka mësimdhënës me shkollë të lartë pedagogjike apo baçellor me 180 poena dhe marrin pagë sikur të jenë me fakultet, që përbën shkelje dhe keqpërdorim të parasë publike, prandaj kërkoi nga kryetari që për mbledhjen e ardhshme të urdhëroj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit që të na paraqet një informatë të saktë me tërë këto parregullsi të cekura.

**Veli Karaça, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha se sa i përket investimeve, kemi qenë ndër komunat më me fat, mirëpo këto investime gjithmonë duhet të përcillen sipas prioriteteve dhe cilësia e punëve të kryera, duke shtuar që ka pasë edhe projekte që janë kryer me prioritet dhe me cilësi, por jo gjithmonë, edhe shtrirja e këtyre investimeve duhet të jetë në tërë territorin e komunës sonë, por ka raste që shumë projekte janë koncentruar në disa bashkësi lokale, dhe në disa fshatra. Mandej shërbimet publike nuk kanë qenë në nivel, duke shtuar se problemi i ujit është problem jetik, prandaj duhet të angazhohemi që në rend të parë shpërndarja e ujit nga kompania rajonale të jetë e drejtë, pasi që jemi të diskriminuar për sasinë e ujit, për cilësinë e ujit, për faktin se një pjesë të madhe të kohës gypat janë të zbrastë dhe uji vjen i papastër, i cili është edhe i rrezikshëm për jetën e qytetarëve, pasi që një pjesë e rrjetit të ujësjellësit është edhe prej gypave të asbestit që kanë materie kancerogjene. Gjithashtu problem kyç është çështja e pagesës së ujit, sepse pagesa paushalle nuk e stimulon kursimin e ujit, apo shfrytëzimin racional, dhe shtoi se qytetarët e Vushtrrisë e paguajnë një pjesë të madhe të ujit që e shfrytëzojnë qytetarët e komunave tjera, pasi që çmimi sado modest i ujit që paguhet në nivel rajonal, paguhet njësoj sikur ata që kanë 24 orë ujë, sikur ata që kanë 2 apo 4 orë ujë, dhe kjo padrejtësi që ka vazhduar me vite është dashtë të tejkalohet. Sa i përket energjisë elektrike, për qytetarët e komunës sonë është problem i dyfishtë, sepse kur nuk kemi rrymë, nuk kemi as ujë, pasi që në mungesë të ujit nga rrjeti, qytetarët furnizohen prej puseve përmes hidroforëve. Problemi tjetër është ambienti dhe pastërtia e qytetit, përkundër të gjitha angazhimeve dhe investimeve që janë bërë për ta përmirësuar ambientin, akoma ka probleme të mëdha të cilat në një masë janë të natyrës organizative, pasi që një pjesë e madhe e qytetarëve nuk kanë kontrata me kompani për menaxhimin e mbeturinave, prandaj kjo çështje duhet të jetë brengë e komunës, dhe duhet rishikuar përqindjen, kurse ata që nuk kanë mundësi për të paguar, le t'i mbulon (financon) komuna.

**Vlora Qirezi, anëtare e Kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha se në pjesën ku flitet për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në ballinë thuhet "Raporti i punës janar-qershor 2010", kurse në faqen e dytë thuhet "Raporti i punës janar-qershor 2009". Poashtu, në raport thuhet se janë bërë hapa në lëmin e kulturës dhe sportit, duke shtuar se në periudhën e okupimit të Kosovës ka pasur më tepër aktivitete kulturore në Komunën e Vushtrrisë, se sa që ka tash. Ndërsa lidhur me masivizimin e rinisë nuk është punuar sa duhet, kurse Qendrën Kulturore "Hasan Prishtina" duhet ta vizitojnë më shumë të rinjtë në mënyrë që t'i shmangen kafiterive, prandaj në këtë drejtim Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit duhet të jetë më kreative. Në vazhdim tha se sporti në Vushtri po përjeton degradime, pasi që sot mund të flitet vetëm për rezultatet e arritura para disa viteve, sepse sot kemi dështime, dhe këtë e ilustron fakti se klubet që kanë arritur të bëjnë gara në arenën ndërkombëtare, sot luftojnë për mbijetesë, siç është klubi hendbollistik "Kosova", poashtu ka klube që për shkak të mospjesëmarrjes kanë rënë në rangje më të ulta, prandaj Grupi parlamentar i LDK-së ka ardhur në përfundim se këto dështime janë si rezultat i mungesës financiare, kështu që propozojmë që të investohet më shumë që të ngritet cilësia. Gjithashtu, Grupi parlamentar i LDK-së kërkoi që ta din fondin e librave në bibliotekën e qytetit, pasi që nuk ka të dhëna në raport. Në fund lidhur me barazinë gjinore pyeti se çfarë aktivitete ka bërë Zyra për Barazi Gjinore, pasi që në raport thuhet se është përmirësuar pozita e femrave.

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha se takimet e rregullta me drejtorë të drejtorive, pastaj takimet me qytetarë nuk kanë nevojë të përfshihen në raport, pasi që puna e kryetarit është që të ketë takime me drejtorët e drejtorive dhe me qytetarët, dhe kjo përfshirje e këtyre takimeve sikur e zvetënon



raportin e kryetarit. Pastaj lidhur me ekonominë dhe bujqësinë, tha se është një shqetësim i ngritur për çështjen e ujitjes, pra atje ku janë kanalet e ujitjes me sistemin e Ibër Lepencit, duke shtuar se janë shpenzuar të holla të shumta për renovimin e kanalit nga kanali kryesor, dhe të gjitha ato të holla që janë dhënë, projekti ka qenë i dështuar, prandaj është mirë që të përmirësohet kjo çështje. Në vazhdim sa i përket arsimit, tha se po kalojnë caq shumë vite dhe 5-6 shkolla janë pa emra, dhe kjo është një anomali që nuk duhet të vazhdojë më tutje, prandaj çështja e emërimit të shkollave dhe ndarja e tyre duhet të konsiderohet e mbyllur. Mandej, shtoi se vetëm ndërtimi dhe renovimi i shkollave nuk e sjellë cilësinë e nivelit të arsimit, dhe këtu hyjnë edhe shumë laboratorë, biblioteka, fondi i librave është i tejkaluar, prandaj komuna duhet të mendojë që bibliotekën ta furnizoj edhe me libra të shkollave. Në fund tha se nuk është i informuar cilat masa janë ndërmarra në arsim, pasi që thuhet se janë marrë masa për përmirësimin e nivelit të arsimit, përveç që ka pasur ndërtime të godinave.

**Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit-** tha se komuna ka të arritura, por brengosëse është që këto të arritura nuk po materializohen në raport dhe nuk po justifikohen. Në vazhdim paraqiti një sublimim të shqetësimeve të Grupit parlamentar të LDK-së, duke thënë se komuna nuk ka krijuar ambient të favorshëm për lindjen dhe zhvillimin e bizneseve, përkundër që ka avancuar shumë në infrastrukturën e rëndë fizike; puna njëvjeçare e administratës komunale nuk ka manifestuar operime atraktive për investitorët; komuna nuk ka arritur t'i përmirësojë as mësimdhënien dhe as mësimnxënien; investimet në shëndetësinë komunale as për së afërmi nuk iu ofruan outputeve respektive të kundërvlefshme; komuna vazhdon të mbetet njëri prej qyteteve më të papastërta në vend; ndërtimet e egra po gllabërojnë edhe atë pjesë të vogël të tokës punuese që ka mbetur; komuna tokën pjellore nën sistemin e shtrenjtë të rigacionit e shndërron në beton dhe kubëza; një pjesë e raportit nuk krahasohet me planin strategjik të zhvillimit ekonomik, që e ka hartuar dhe aprovuar komuna; raporti i kryetarit të komunës tkurret vetëm në administratën komunale; raporti nuk përmban elemente qenësore të raportit të punës së kryetarit; raporti nuk përfshin as indikatorët më elementarë të matshëm të performancës së komunës; indikatorët e buxhetit komunal komunën tonë e nxjerrin si një qendër efikase shpenzuese të taksave të qytetarëve; raporti nuk bën krahasime me planin e aprovuar të punës; komuna nuk din t'i menaxhojë asetet e veta; Raporti vjetor i Drejtorisë për Buxhet dhe Thesar ishte sa qesharak, po aq edhe për keqardhje, 12 informatat për të hyrat vetjake nuk pasqyruan gjendjen e vërtetë me raportin përfundimtar; komuna nuk din të tregojë se çfarë ka shitur, përderisa raporti vjetor i Drejtorisë së Buxhetit fliste për ekstra profite miliardëshe të aseteve të shitura, kurse komuna nuk ka akoma listë të aseteve; nuk ka pasur plan të aprovuar për implementimin e rekomandimeve të auditorëve; nuk ishte bërë matja e vlerësimit të eficiencës së stafit të komunës; përcipioni i qytetarëve është se ka ndërhyrje të shumta në vendimet e prokurimit; dhe më brengosësja është që komuna nuk e justifikoj që qenurit e Vushtrrisë si qytet i lashtë.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** tha se nuk ka mundur që t'i përfshin të gjitha të arriturat në raportin e punës, dhe shtoi se maksimumin e energjisë dhe kapacitetit intelektual dhe aftësisë organizative e ka dhënë për interesin e të gjithë qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, duke mos bërë dallime partiake, dhe as dallime të natyrave tjera. Sa i përket vërejtjes që raporti i punës me qenë i matshëm me planifikimin, tha se ka pasur edhe projekte që nuk janë planifikuar fare, por janë realizuar edhe jashtë planifikimit. Ndërsa lidhur me krijimin e Drejtorisë së Bujqësisë, tha se mund të debatohet për të dhe se pajtohet që të krijohet, duke i shikuar mundësitë se çfarë mund të bëhet. Në vazhdim njoftoi që është duke u punuar në drejtim të ndërtimit të parkut të biznesit. Kurse lidhur me emërtimin e shkollave, tha se ka pasur pengesa, pasi që janë ngritur shumë shqetësime dhe shumë kërkesa nga qytetarët e ndryshëm. Gjithashtu, tha se për këtë vit është i planifikuar një fond i vogël i mjeteve për blerje të librave për bibliotekë, duke shtuar që në të ardhmen do të bëjnë përpjekje për bërjen e një biblioteke të qytetit në një vend më të përshtatshëm, dhe si një ndër vendet e

përshtatshme e përmendi një pjesë të shtëpisë së Mahmut Agë Gjinollit. Në fund duke iu referuar shqetësimeve të ngritura lidhur me cilësinë në mësim, tha se është i preokupuar, por janë disa parametra të cilësisë në mësim që domosdoshmërisht duhet plotësuar, prandaj është munduar që të plotësohen ato, siç është krijimi i hapësirës shkollore.

**Safet Idrizi, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Çështje Sociale-** lidhur me vërejtjet e bëra nga P.Pllana për kujdesin parësor shëndetësor, tha se gjatë vitit 2010 numri i pacientëve ka qenë 159.239, prej tyre 94.85 % janë trajtuar në nivelin primar, kurse 5.15 % janë referuar. Sa i përket shërbimit të vaksinimit, sipas raporteve që i ka marrë, gjendja është e kënaqshme, duke pasur parasysh faktin që nuk ka raste të paraqitjes së sëmundjeve akute infektive tek fëmijët. Ndërsa, lidhur me kontrollimin e ujit të pijshëm, u përgjigj se nëpër disa fshatra janë marrë mostrat dhe janë bërë analizat kimike dhe bakteriologjike, duke shtuar se analizat i bën Instituti rajonal i shëndetit publik, me të cilët është lidhur një kontratë dhe analizat bëhen sipas kërkesave të palëve. Sa i përket sëmundjeve infektive për periudhën janar-dhjetor 2010, njoftoi se hepatit B dhe C janë tri raste. Pastaj kanë qenë 16 raste të tularemisë, dhe shqetësuese janë paraqitjet e 41 rasteve të reja të tuberkulozit, e kjo ndërlidhet me gjendjen e rëndë ekonomike sociale. Kurse lidhur me skemën e ndihmave sociale, tha se punët janë të ndara në dysh me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe kjo ministri e ka sektorin e kontrollit dhe ata e caktojnë komisionin mjekësor, pra DSHMS-ja nuk ka të drejtë për të verifikuar rastet se sa janë të arsyeshëm për ndihma. Në fund njoftoi se gjatë vitit 2010 janë subvencionuar për strehim 37 familje, kurse 64 familje janë subvencionuar për shërim, subvencionim për ushqim 315 familje.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa-** tha se versioni i parë i pasqyrave financiare kur është dorëzuar, ai ka qenë version fillestar, kurse pas këtij versioni janë dorëzuar edhe dy versione tjera, ndërsa versioni i fundit është më 28.03.2011, pra ky është versioni final, dhe shtoi se me 26 mars është bërë prerja e të hyrave në sistemin e menaxhimit të financave, pra të hyrat e bartura për Komunën e Vushtrrisë janë 322.269 €. Pastaj, në raportin e punës të kryetarit është paraqitur në mënyrë të kjartë se shpenzimi i buxhetit është realizuar 99.68 %, që nënkuptohet se asnjë mjet nuk ka shkuar në suficit, falë menaxhimit të mirëfilltë, dhe është realizuar fondi 10 në përpikëri, kurse fondet 21, 22 dhe 31, këto janë fonde që barten në vitin në vijim.

**Sami Istrefi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike-** lidhur me shqetësimin e ngritur për kualitetin e ujit të pijshëm, tha se është angazhuar zyrtarisht që ta dijmë edhe nga ana e kompanisë se a bëhen analizat, si bëhen a kemi ndonjë raport zyrtar për ujin e pijshëm që vjen nga fabrika në rezervuarin e ujit të pijshëm në Vushtrri, prandaj nga Enti Higjienik çdo javë bëhen analizat e ujit dhe në kooperim të vazhdueshëm me inspektorin sanitar të komunës sonë. Ndërsa, sa i përket pyetjes së V.Karaçës lidhur me shpërndarjen e ujit të pijshëm, tha se jemi angazhuar me drejtorin e ujësjellësit dhe pasi që të merret sot vendimi për racionalizimin e ujit të pijshëm, kemi menduar që ta formojmë një Task Forcë kur do të përfshihen edhe policia, komuna dhe kompania për t'i evituar të gjitha rrjedhjet e mundshme të keqpërdorimit të ujit të pijshëm, si dhe shpuarja e gypit kryesor i cili vjen nga Bajri në rezervuarin e ujit, pasi që aty ka shpuarje ilegale, dhe e njëjta përbën vepër penale, por e cila asnjëherë nuk është trajtuar seriozisht. Gjithashtu jemi angazhuar edhe lidhur me pagesat e ujit të pijshëm, mirëpo gjithmonë ka ardhur arsyetimi se organi rregullativ i përcakton çmimet, prandaj nuk është kompania kompetente në përcaktimin e çmimeve. Në fund lidhur me vërejtjen e R.Ramajt se qyteti i Vushtrrisë është ndër qytetet më të ndotura, tha se komuna nuk i menaxhon kompanitë që janë kompetente për mbajtjen e pastërtisë së qytetit, por përkundër vështirësive komuna është e angazhuar dhe kompania në fjalë që vërtetë ta kemi një qytet të pastër.

**Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit-** tha se drejtori i shërbimeve publike është ngatërruar, pasi që këtu po flitet për raportin e vitit 2010, kurse drejtori iu referua angazhimeve të drejtorisë në fjalë për vitin 2011.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota “për”, 4 “kundër”, të tjerët “abstenim” vendosi me sa vijon:**

***Aprovohet raporti në fjalë me vërejtjet dhe sugjerimet e anëtarëve të Kuvendit.***

### **3. Shqyrtimi dhe aprovimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të Statutit të Komunës.**

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit-** njoftoi se ka kaluar kohë e gjatë që komisioni ka punuar dhe i ka realizuar disa mbledhje, duke shtuar se është bërë një punë e përbashkët në drejtim të ndryshimit dhe plotësimit të Statutit të Komunës.

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit-** tha se komisioni është dashtë në bashkëpunim me sekretarinë që të gjitha ndryshimet të cilat na vijnë prej draftit që është aprovuar për diskutim publik në këtë kuvend, të na vijnë me një material të bashkangjitur, duke shtuar se në draftin e parë për ndryshim të Statutit te neni 43 kemi pasur dispozitën që e parasheh mënyrën e shkarkimit të kryesuesit, dhe në pikën 1 të këtij neni thuhet se kryesuesi i kuvendit mund të shkarkohet me 50 % plus një votë të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit, ndërsa në draftin që sot e kemi dhe që ka ndryshuar, në nenin 42 thuhet se shkarkimi i kryesuesit të kuvendit bëhet me 2/3 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit, prandaj këto ndryshime është dashtë të vijnë me një akt përcjellës për të arsyetuar pse ka ardhur te këto ndryshime. Pastaj te neni 79 thuhet Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim, kurse në draftin e aprovuar për diskutim publik kjo drejtori emërtohet Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, prandaj edhe kjo është dashtë të përcillet me një akt që do të arsyetonte pse janë bërë këto ndryshime. Në fund në emër të Grupit parlamentar të LDK-së paraqiti këto propozime: neni 42 që ka të bëjë me shkarkimin e kryesuesit të mbetet ashtu siç ka qenë në draftin e parë; te neni 79 të jetë Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe kur të ndërrohet kjo, duhet të ndërrohet edhe neni 74 duke u riformuluar dhe të thuhet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, duke përshkruar punët e kësaj drejtorie.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të AAK-së neni 41 dhe 42 duhet të jenë nene homonime, pra kërkojmë që neni 42 të mbetet ashtu siç ka qenë, kurse të mbetet që kryesuesi i kuvendit mund të shkarkohet me 50 % plus një votë. Pastaj, tha se komuna jonë duhet ta ketë edhe Drejtorinë e Bujqësisë, pasi që është kërkuar shumë herë që të krijohet drejtoria në fjalë, duke propozuar që ekonomia të bartet në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** lidhur me nenin 9 të Statutit, tha se ka emërtime të cilat paksa kanë ndryshuar, kurse disa kanë mbetë ashtu siç kanë qenë edhe më herët, prandaj pyeti pse nuk janë ndryshuar të gjitha, duke kërkuar që këto çështje të sqarohen, sepse nëse mbeten kështu siç janë në Statut, munden me pasë probleme në dokumentacione duke përmbajtur dy emërtime të ndryshme për të njëjtin fshat.

**Haki Maloku, përgjegjës i Sekretarisë-** te neni 53 i Statutit, tha se formulimi i paragrafit 53.1 nuk korrespondon me nenin 52.1 të LVL-së, ku përmendet përbërja e KPF-së, por në Statut nuk definohet që anëtarët e KPF-së duhet të jenë nga radhët e anëtarëve të kuvendit, kurse në LVL përmendet. Poashtu, Statutit i mungon kapitulli që bën fjalë për përdorimin e gjuhëve në komunë, prandaj në pjesën e dispozitave të përgjithshme të Statutit duhet të përfshihet edhe një kapitull i veçantë për gjuhët në komunë.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit-** tha se në bazë të Udhëzimit Administrativ 2011/3 të MAPL-së, komuna është e detyruar që të formojë zyrën për organizimin dhe funksionimin e qendrave të shërbimeve të qytetarëve në komuna, prandaj propozoi që të shtohet tek neni 70 një pikë e veçantë. Gjithashtu në emër të Grupit parlamentar të PDK-së propozoi që të rritet numri i anëtarëve të Komitetit për Komunitete nga 7 në 9.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** tha se do të ishte mirë që ekonomia, bujqësia, financat të ishin drejtori të veçanta (të pavarura) nga njëra tjetra, dhe shtoi se nëse ekonominë e bartim në Drejtorinë e Financave, atëherë vetëm ia shtojmë një barrë më shumë drejtorisë në fjalë, kurse drejtori i kësaj drejtorie e ka të vështirë menaxhimin e atij numri të madh të punëtorëve aktual, kurse po mendohet që edhe stafin e sektorit të ekonomisë me ia bartur në atë drejtori, prandaj nëse veprohet kështu, nuk është menaxhim i mirë, prandaj ka propozuar që të mbetet ashtu siç ka qenë, por nëse mendohet me ndërruar, atëherë duhet bërë ekonomia, financa, bujqësia të gjitha drejtori të veçanta.

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit-** propozoi që neni 42 të mbetet ashtu siç ka qenë, pra shkarkimi i kryesuesit të bëhet me 50 % plus 1 votë. Pastaj të korrigojohet neni 53. Të definohet me një nen të veçantë të dispozitat e përgjithshme përdorimi i gjuhëve në territorin e Vushtrrisë dhe gjuhëve në përdorim zyrtar. Kurse emërtimet e vendbanimeve janë të përcaktuar me Ligjin për kufijt administrativ, dhe duhet të përkthehet edhe në gjuhën serbe. Ndërsa mbetet emërtimi i drejtorisë Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, deri në ndryshimin e LVL-së, i cili është në procedim, dhe pasi që të aprovohen ndryshimet dhe plotësimet e LVL-së, jemi të obliguar që disa nene të Statutit me i ndryshuar, dhe do ta formojmë Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural si drejtori të veçantë. Gjithashtu edhe numri i anëtarëve të Komitetit për Komunitete të rritet deri në 9, ashtu sa është edhe numri i anëtarëve të KPF-së.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota “për”, 6 “kundër”, të tjerët “abstenim” vendosi me sa vijon:**

**Aprovohen ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të Komunës me vërejtjet dhe propozimet e anëtarëve të Kuvendit të paraqitura në mënyrë të përmbledhur nga kryesuesi i Kuvendit.**

**4. Draft-Rregullore për shërbimin e transportit me “merimangë” për territorin e Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i parë).**

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Ipet në diskutim publik Draft-rregullorja për shërbimin e transportit me “merimangë” për territorin e Komunës së Vushtrrisë.***

***Diskutimi publik fillon nga data 29.04.2011 dhe zgjatë deri më 16.05.2011.***

**5. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim pa kompensim të tokës në pronësi të Komunës për ndërtimin e objektit për regjistrimin e automjeteve dhe Qendrën e Regjistrimit Civil nga MPB-ja.**

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Me këtë Vendim ipet në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim, në afat prej 10 vjetësh me mundësi vazhdimi, toka në pronësi të komunës, pjesë e parcelës kadastrale P70202016-01119-1, Certifikata e pronësisë UL-70202016-01534, në sipërfaqe prej 700m<sup>2</sup>, ZK-le Vushtri, për ndërtim të Objektit për Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve dhe Qendrën e Regjistrimit Civil.***

***Komuna e Vushtrrisë mbetet pronare legjitime e tokës të përcaktuar në nenin 1 të këtij Vendimi.***

## **6. Propozim-vendimi për racionalizimin e ujit të pijes nga rrjeti i ujësjetës të qytetit gjatë sezonës verore.**

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** rikujtoi se ka qenë një Urdhëresë nga ish-drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike që iu ka dedikuar racionalizimit të ujit të pijshëm, gjatë etj, prandaj është e panevojshme prapë me qenë kjo çështje diskutimi, duke pyetur pse të mos zbatohet Urdhëresa që ka qenë, duke shtuar se mund të nxirren vendime, por problemi është zbatimi i tyre në praktikë. Mandej, tha se nuk ka pasë një raport se a është zbatuar apo nuk është zbatuar Urdhëresa në fjalë, sikur që nuk ka pasë raport nëse janë shqiptuar gjatë, dhe nëse janë inkasuar mjete nga gjatë e shqiptuara për shkak të keqpërdorimit të ujit.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit-** pyeti kryetarin se a ka mundësi që komuna e jonë, pasi që e ka lumin Sitnica, dhe pasi që ka burime të ujit, të bën një plan dhe të kemi të ndarë ujin e pijshëm të fabrikuar nga uji teknik (industrial). Mandej duke iu referuar nenit 3.1, propozoi që t'i shtohet fjalia "me ujë të fabrikuar (të pijshëm)". Gjithashtu tha se problemi i ujit në Vushtrri është emergjent gjatë tërë vitit. Mandej, problem tjetër është se çfarë cilësie ka uji i pijshëm që po e përdorim, duke ai shtuar kësaj çështje edhe një konstatim të para disa muajve të P.Pllanës se ne po pjmë ujë prej gypave të asbestit, prandaj pyeti se a ka mundësi kjo komunë me i hjek ata gypa?

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të PDK-së e mbështeti propozim-vendimin në fjalë.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** lidhur me çështjen e ngritur të ujit teknik, tha se shumë lehtë mund të furnizohet qyteti me ujë teknik, por mungon infrastruktura e rrjetit, pra duhet bërë një infrastrukturë tjetër. Kurse sa i përket gypave të asbestit, duke iu referuar vlerësimeve të profesionistëve në lëminë në fjalë, tha se sipas tyre gypat e asbestit mund të shkaktojnë rrezik nëse janë të prishur, dhe nëse nëpër atë pjesë të prishur kalon uji i pijshëm.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Me këtë vendim përcaktohen masat dhe kriteret e përdorimit racional të ujit të pijes gjatë periudhës emergjente, për shkak të mungesës së ujit në sistemin publik të ujësjetës në Komunën e Vushtrrisë.***

***Definicione:***

***"Periudha e emergjencës"* nënkupton periudhën prej 01 Prill 2011 deri më 31 tetor 2011.**

***"Ujë i pijshëm"* nënkupton ujin nga sistemi publik i furnizimit me ujë të pijshëm.**

***"Person"* nënkupton personin fizik ose juridik.**

***"Person i kualifikuar"* nënkupton atë që e ka të regjistruar biznesin për autolarje.**

***"Leje e posaçme"* nënkupton leje në kuptim të nenit 4 të kësaj Urdhërese.**

## **7. Propozim-vendimi për lejimin e bartjes së mjeteve financiare nga të hyrat vetanake prej vitit 2010 në vitin 2011.**

**Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit-** tha se pajtohet që mjetet e mbetura nga viti 2010 të barten në vitin 2011 dhe të shfrytëzohen në mënyrë racionale, por kërkoi sqarim pasi që këto mjete që kanë mbetur të pashfrytëzuara në vitin 2010 janë decidivisht mjete nga të hyrat vetanake, dhe këto decidivisht duhet të shfrytëzohen për investime kapitale, prandaj pyeti pse tek shëndetësia dhe arsimit është kjo formë dhe kjo shumë e bartjes prej 10.000 € në paga dhe mëditje në shëndetësi, dhe në arsim prej 14.933 €.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** lidhur me propozim-vendimin në fjalë, tha se te arsyetimi i paraqitur nuk ka mjaft argumente të qëndrueshme, dhe duke iu referuar paragrafit të dytë të arsyetimit, pyeti pse kemi mbetje të mjeteve financiare, prandaj

Drejtoria për Buxhet dhe Financa duhet të paraqes shpjegim për anëtarët e kuvendit në arsyetim.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa-** lidhur me pyetjen e Z.Hasanit, u përgjigj se në fillim të muajit nëntor mbyllet afati i zotimit të mjeteve, dhe të hyrat e grumbulluara të nëntorit dhe dhjetorit barten në vitin vijues, duke shtuar se për arsim kjo bartje është bërë për shkollat profesionale, që mbajnë provime private, të cilat janë bartur nga viti 2010 në vitin 2011. Gjithashtu edhe në shëndetësi janë për mëditjet jashtë orarit të punës. Sa i përket pyetjes së B.Jasharit, tha se mjetet e zotuara që janë për investime kapitale të fondit 21 dhe 22, janë mjete që barten në vitin vijues për të njëjtat projekte, pa iu ndërruar destinimi.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Me këtë vendim lejohet bartja e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të vitit 2010 në vitin 2011 në shumë të përgjithshme prej 322,269.81€, të cilat do të shpërndahen si vijon:***

***a) Shëndetësi, shuma për bartje 18,479.53€ ndahet në:***

***- Kategorinë e pagave dhe mëditje -10.000.00 €,***

***- Kategorinë e Mallrave&shërbimeve - 8,479.58.00 €***

***b) Arsimit, shuma për bartje 77,719.79 € ndahet në:***

***-Mjete për paga dhe mëditje -14,933.49 €***

***-Kategorinë e mallrave&shërbimeve - 62,786.30 €***

***c) Administratë e përgjithshme, shuma prej 226,070.49 € bartet për përfundimin e projekteve kapitale .***

**8. Propozim-vendimi për përcaktimin e lartësisë së kompensimit të anëtarëve të Komitetit për Auditim të Komunës së Vushtrrisë.**

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** propozoi që anëtarët e komitetit në fjalë të kompensohen në shumën e njëjtë që kompensohen anëtarët e KPF-së, në shumën prej 50 €.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Me këtë vendim përcaktohet lartësia e kompensimit të anëtarëve të Komitetit për Auditim të Komunës së Vushtrrisë.***

***Lartësia e kompensimit për çdo anëtar të Komitetit për Auditim është 50.00 € (pesëdhjetë euro) për pjesëmarrje në mbledhje të këtij komiteti.***

***Pagesa e mjeteve në shumën e cekur në nenin paraprak do të realizohet nga mjetet e buxhetit të komunës.***

**9. Propozim-vendimi për anulimin e vendimit të KK-së për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës së paluajtshme të komunës.**

**Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit-** tha se vitin e kaluar Grupi parlamentar i AAK-së i ka paraqitur vërejtjet e veta, duke shtuar se nga kjo del se investitorët e interesuar dhe dhënia e pronave qëllimisht individëve të caktuar ka qenë e dyshimtë në fillim dhe e dyshimtë do të jetë, dhe dështimi është pranë.

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit-** Grupi parlamentar i LDK-së nuk do ta mbështesë anulimin, sepse ka qenë një vendim që qysh atëherë e kemi kundërshtuar.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit 17 vota “për”, të tjerët “abstenim” vendosi me sa vijon:**

**Anulohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr.220/10, dt.30.09.2010, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim, të pronës së paluajtshme të komunës, z. Shyqyri Selmanit pronar i Sh. P. K. "Barileva" në fsh. Prugofc, Komuna e Prishtinës, pjesa e parceles kadastrale nr.412/8, certifikata e pronësisë nr. 198, në sipërfaqe prej 01.00.00 ha, ZK-le Stanoc i Poshtëm, pronë e komunës së Vushtrrisë.**

**10. Propozim-vendimet për lejimin e mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për:**

**a. Blerjen e kohë pas kohshme të gjërave ushqimore për familjet në gjendje të rëndë ekonomiko-sociale.**

**b. Bartjen e mjeteve financiare për rindërtim për familjet me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale.**

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit-** Grupi parlamentar i AAK-së i mbështet vendimet lidhur me ndihmat nga subvencionet dhe transferet, mirëpo kërkojmë transparencë kur bëhet fjalë për rindërtime, në mënyrë që të dihet se kush ka konkurruar, kush ka paraqitur kërkesa.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar një shkrimi në gazeta lidhur me dëmin që iu është shkaktuar një biznesi familjar në fshatin Akrahticë, ku janë djegur 7.000 zogjë, pyeti a ka pasur ndonjë përkrahje nga ana e komunës ai biznes për shkak të dëmit që iu është shkaktuar?

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** duke iu përgjigjur pyetjes së B.Jasharit, tha se është evidentuar ai rast nga njësi të përbërë nga Drejtoria për Emergjencë dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Bujqësi, kurse kërkesën ia kemi dërguar Ministrisë së Bujqësisë, dhe ata kanë premtuar se do ta ndihmojnë, duke shtuar që nuk kemi kërkesë prej palës së dëmtuar që Komuna e Vushtrrisë me i ndihmuar.

**Në fund të diskutimit lidhur me këto nënpika të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**Aprovohen propozim-vendimet në fjalë.**

**c. Propozim-vendimi për ndihmë për klubet sportive të Komunës së Vushtrrisë.**

**c1. Propozim-vendimi për ndihmë ekipit të futbollit "Radnik" nga Prelluzha.**

**c2. Propozim-vendimi për ndihmë KV-Gjimnazisti dhe KKBOX "Kosova" (F+M).**

**c3. Propozim-vendimi për ndihmë Klubit të shahut "Llamkos".**

**Esat Beka, anëtar i Kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të PDK-së propozoi që ndarja e mjeteve për klubet sportive të jetë kështu:

KF " Artakolli "	2.400 €
KH " Kosova " ( F )	1.600 €
KH " Kosova " ( M )	1.600 €
KF " Kosova "	2.400 €
KB " Vushtrria-Basket "	1.400 €
KV " Kosova " ( F )	1.400 €
KM " Kosova "	500 €
KF " Vushtrria `92", të hiqet krejt, sepse ky klub nuk ekziston.	
KV " As Vushtrria "	800 €
KV " Gjimnazisti "	1.100 €
KBox " Kosova "	500 €
KPp " Hasan Prishtina "	500 €
KKBox " Kosova " ( F +M )	1.000 €
KSH " Llamkos "	750 €
KSH " Shqiponja "	750 €

Shoqata e Peshkatarëve “ Sitnica “ .....	500 €
KGj “ Kosova “ .....	500 €
Muhamet Rama ( Veteran i atletikës ) .....	300 €

Në vazhdim në emër të Grupit parlamentar të PDK-së kërkoi nga drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport që të sjellë një raport për të hyrat dhe të dalurat për tërë vitin 2010. Pastaj shtoi se palestra sportive ka 7 punëtorë, kurse ka shumë të hyra të vogla.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** lidhur me KH “Kosova” (F), tha se ky klub ka pasur rezultate në nivel nacional, prandaj përveç rezultateve që ka treguar, por pasi që është klub i femrave, e meriton përkrahjen e nevojshme prej kuvendit, dhe jo vetëm këtij klubi, por çdo klubi të femrave duhet dhënë prioritet, dhe në emër të Grupit parlamentar të LDK-së e mbështet propozimin e paraqitur për këtë klub nga drejtorja në fjalë.

**Veli Karaça, anëtar i Kuvendit-** tha se kjo shumë e mjeteve nuk i plotëson nevojat e sportit të komunës, prandaj edhe obligohemi të jemi më racional për disa kategori tjera që nuk janë të rëndësishme sikur që është rinia dhe sporti. Në vazhdim lidhur me KH “Kosova” (M), tha se garojnë në super ligë janë tri ekipe: seniorët, juniorët dhe kadetët, i zhvillojnë 28 lojëra, prej tyre 14 jashtë vendit, 14 brenda, për çdo ndeshje që zhvillojnë në Vushtrri duhet t'i paguajnë tre refer dhe mirëmbajtësin e të dhënave, ndërsa kur zhvillojnë lojëra jashtë Vushtrrisë, duhet ta paguajnë transportin, duke shtuar se me shumën prej 2.200 € as kuotizimin nuk mund ta paguajnë. Në fund propozoi që klubit në fjalë t'i rritet shuma në 3.000 €.

**Qamil Sahiti, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport-** tha se në faqen e fundit të propozim-vendimit në fjalë është një tabelë, drejtorja jonë është munduar që të krijoj disa kriteret në bazë të cilave do të mund të subvencionoheshin këto klube sportive, duke shtuar që këto ndihma që i kemi propozuar, klubet sportive brenda një muaji i shpenzojnë. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me kriteret e përcaktimit të shumave për klubet sportive në këtë propozim-vendim. Në fund lidhur me çështjen e palestrës, tha se nuk është palestra ajo që i sjellë të hyra komunës, por palestra e mban të gjallë shpirtin e këtij qyteti në zhvillimin e sportit.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit-** Grupi parlamentar i PDK-së e mbështet propozimin e E.Bekës, duke shtuar se klubet e hendbollit zhvillojnë shumë më pak ndeshje se sa klubet e futbollit, poashtu klubet e hendbollit “Kosova” femrat dhe meshkujt nuk kanë asnjë garë në arenën ndërkombëtare, pasi që kanë rënë në nivel.

**Makfirete Ademi, anëtare e Kuvendit-** Grupi parlamentar i AAK-së e mbështet propozimin e paraqitur nga DKRS-ja.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** tha se ka kërkuar nga drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport që t'iu jep përparësi ekipeve që kanë suksese më së shumti, duke shtuar se propozimi i drejtorit është propozim i kryetarit.

**Në fund të diskutimit lidhur me këto nënpika të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**Aprovohen propozim-vendimet në fjalë ashtu siç janë propozuar nga Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport.**

- d. SHFD-në e UÇK-së, në shumë prej 3600 €.
- e. OVL-në e UÇK-së, në shumë prej 3600 €.
- f. SHIL-in e UÇK-së, në shumë prej 3600 €.
- g. Shoqatën e Ish të Burgosurve Politik, në shumë prej 1800 €.
- h. Ndihmë për Shoqatën e Martirëve në Vushtrri, në shumë prej 1800 €.
- i. Ndihmë në vlerë prej 1500 €, për familjen e Bajram Pantinës, ish punëtor i Komunës.
- j. Ndihmë për shërim për Arben Mujën, nga Vushtrria.



**Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit**- tha se shoqatat kanë marrë ndihma në të holla edhe më herët, prandaj pyeti a kanë raportuar ndonjëherë dhe a dihet kujt iu kanë ndarë këto ndihma, dhe kërkoi që në të ardhmen të raportohet në kuvend.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës**, tha se këto shuma të propozuara për shoqatat në fjalë duhet që brenda këtyre shumave të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet për rrymë, higjienë dhe nevoja tjera.

**Në fund të diskutimit lidhur me këto nënpika të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**Aprovohen propozim-vendimet në fjalë.**

#### **11. Të ndryshme:**

**a. Propozim-vendimi për themelimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të lokaleve të dy shkollave të mesme të ulta në qytet: SHMU 1 dhe SHMU 2.**

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit**- propozoi për anëtarë të komisionit në fjalë Selim Rrustemin.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit**- propozoi për anëtarë të komisionit në fjalë Sabri Feratin.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Themelohet Komisioni për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të lokaleve të dy shkollave të mesme të ulta në qytet:***

***-SHMU 1 dhe SHMU 2, me destinim – mini restorant për nevoja të nxënësve dhe personelit të punësuar në ato shkolla.***

***Në përbërje të komisionit caktohen:***

***-Selim Rrustemi, anëtar i KK-së,***

***-Sabri Ferati, anëtar i KK-së,***

***-Hyda Dallku.***

**b. Diskutimi lidhur me çështjen e mungesës së energjisë elektrike në Vushtrri.**

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës**- tha se edhe në seancën e kaluar e ka shprehur shqetësimin personal dhe të qytetarëve për mungesën e gjatë të rrymës në Komunën e Vushtrrisë. Pastaj shtoi se edhe gjatë mandatit të parë ka shprehur mospajtimin e tij ndaj KEK-ut lidhur me formën e trajtimit të qytetarëve tanë sa i përket furnizimit me energji elektrike, duke mos u pajtuar në veçanti me shkyçjet kolektive, pasi që nuk kanë të drejtë të bëjnë shkyçje kolektive, sepse çdo familje ka një kontratë me KEK-un. Në fund njoftoi se ka marrë premtime nga drejtori i ri i KEK-ut se më nuk do të ketë shkyçje kolektive.

**c. Pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.**

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit**- propozoi që në seancën e ardhshme të shqyrtohen mundësitë buxhetore dhe të ndahen disa mjete për tu pajisur me mikrofona salla e kuvendit.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit**- kërkoi që në seancën e ardhshme t'i kemi për shqyrtim procesverbalin e seancës së ndërprerë dhe procesverbalin e seancës së jashtëzakonshme.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit**- Grupi parlamentar i PDK-së kërkon nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport raport të veçantë për seancën e ardhshme për të hyrat, të dalurat dhe të punësuarit në DKRS.

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të LDK-së kërkoi që për seancën e ardhshme të sigurohet një informatë për të gjithë ata që kanë përfituar material ndërtimor për vitin 2010, shumën sa kanë përfituar, dhe ata të cilët kanë bërë kërkesa, por që janë refuzuar.

**Bahrije Pllana, anëtare e Kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të AAK-së propozoi që si kuvend komunal të bëjmë një reagim kundër këtij reduktimi të energjisë elektrike në komunën tonë, pasi që po i bëhet një padrejtësi e madhe qytetarëve tanë.

**Mbledhja përfundoi në orën 15:43.**

**Procesmbajtësi:**  
**Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Ferit Idrizi**